



UNMIK



IPVQ

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË**  
**INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU**  
**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO**

<b>QEVERIA E KOSOVËS</b> Ministria e Shëndetësisë	<b>GOVERNMENT OF KOSOVO</b> Ministry of Health	<b>VLADA KOSOVA</b> Ministarstvo zdravstva
--	---	---

**Udhëzim Administrativ (për Shëndetësi) 16/2006**

**Themelimi i Bordit të Përkohshëm Ekzekutiv  
i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës**

Ministria e Shëndetësisë, (tash e tutje Ministria),

- Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001, si dhe me Rregulloren Nr. 2002/5 Mbi ndryshimin e Rregulloreve të UNMIK-ut mbi Ekzekutivin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, në veçanti me shtojcën 6 pika (ii) që të koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë, pika (iii) që të vendosë norma dhe standarde dhe nxjerrë udhëzime për sektorin e shëndetësisë në pajtim me standardet relevante ndërkombëtare, pika (iv) mbikëqyrë zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet tjera sipas nevojës;
- E vendosur në Implementimin e Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr.04/219 të datës 10.10.2006;
- Bazuar në Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve për shëndetësi të Komisionit Ndërministror për Shëndetësi;
- Në përputhje me politikat e Qeverisë së Kosovës për vënien e Ligjshmërisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK);
- E vetëdijshme për nevojën e koordinimit të politikave multisektoriale;
- E vendosur për të sjellur ligjshmëri në institucionet e veta;

Ministria e Shëndetësisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ, me te cilin rregullohet themelimi, organizimi dhe mënyra e ekzekutimit të funksioneve menaxheriale të Bordit të Përkohshëm Ekzekutiv të QKUK;

<b>Adresa Postare / Postal Address / Poštanska Adresa</b> Ministria e Shëndetësisë/ Rr. Zagrebit p.n., Prishtinë Ministry of Health, Zagreb Street nn. Pristine Ministarstvo Zdravstva, Ul. Zagrebska.b.b, Priština	<b>Telephone:</b> + 381 38 212 113	<b>Fax:</b> +381 38 212 233
--	---------------------------------------	--------------------------------





Përmes këtij UA, MeSH shpalle si vijon:

1.1. Ministria e Shëndetësisë themelon **Bordin e Përkohshëm Ekzekutiv të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (BPE i QKUK)**;

1.2. **BPE i QKUK përbëhet prej pesë anëtarësh:**

1. Ass. Dr Abdyl Krasnaiqi, QKUK
2. Prof. Dr Shefqet Luli, QKUK
3. Prof. Dr Ahmet Borivina, QKUK
4. Prof. Dr Sejduallah Hoxha, Fakulteti i Mjekësisë
5. Një ekonomist (MEF)

1.3. **Kryetar i BPE të QKUK do të jetë: Ass.Dr. Abdyl Krasnaiqi**

1.4. **Mandati i BPE të QKUK është jo me shume se një vit nga dita e themelimit;**

1.5. **Me datën e emërimit, BPE i QKUK merr të gjitha funksionet ekzekutive të këtij Institucioni;**

1.6. **BPE i QKUK themelohet jo më shumë se 24 orë nga aprovimi i këtij Udhëzimi Administrativ nga ana e Qeverisë së Kosovës;**

1.7. **BPE i QKUK i raporton Ministrit të Shëndetësisë;**

## 2. **Funksioni dhe detyrat e BPE të QKUK**

2.1. **BPE i QKUK brenda 5 ditësh nga momenti i marrjes së kompetencave si organ ekzekutiv i QKUK do të propozoj Ministrit të Shëndetësisë Rregulloren e Punës;**

2.2. **BPE i QKUK brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh do të:**

- a. Implementoj Statutin e QKUK
- b. Rishikoj Statutin e QKUK dhe do ti propozoj MeSH plotësimet eventuale te komponentës MASHT/FM;
- c. Shpalle Konkursset për të gjitha postet vakante menaxheriale ne QKUK-e (Departamentet dhe klinikat e reja te themeluara sipas Statutit te QKUK);
- d. Rishikon të gjitha Kontratat Komerciale ekzistuese të QKUK me subjekte afariste;
- e. Siguron implementimin e të gjitha Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative të MSH,MEF,MSHP dhe MASHT që ndërlidhen me aktivitetet e QKUK;
- f. Siguron implementimin e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit Gjeneral, Zyrave të Auditimit të Brendshëm të MSH dhe MEF;
- g. Siguron implementimin e Rekomandimeve të Inspektoratit Shëndetësor, Inspektoratit Sanitar dhe Inspektoratit të Punës.

2.3. **BPE i QKUK përpilon Raporte të rregullta javore, mujore dhe tre mujore të cilat i dorëzohen Ministrit të Shëndetësisë;**

2

**Postal Address:**  
UNMIK - Kosovo  
P.O. Box 515 or 596  
1000 Skopje  
FYR Macedonia

**Telephone:**  
Via Pristina PTK:  
+381 38 504 604  
Via UNHQ New York:  
+1(212) 963 8442

**Fax:**  
Via Pristina PTK:  
+381 38 504 604 ext. 4019  
Via UNHQ New York:  
+1 (212) 963 8603/8113  
Internal fax: 4065





- 2.4. BPE i QKUK ekzekuton rekomandimet Grupit të Ekspertëve për Shëndetësi i themeluar në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 04/219 të datës 10.10.2006;
- 2.5. Në periudha gjashtëmujore do të bëhen auditimet e punës së BPE nga ana e Zyrës së Auditimit të Brendshëm të MSH dhe MEF

### 3. Dispozitat Përfundimtare

3.1. Me datën e nënshkrimit të këtij Udhëzimi Administrativ shuhet posti i Drejtorit Ekzekutiv të QKUK;

3.2. Me datën e nënshkrimit të këtij Udhëzimi Administrativ zgjatet për gjashtë (6) muaj afati i implementimit të Statutit të QKUK.

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin nga Ministri i Shëndetësisë.

Prishtinë,

18 Tetor 2006



Prof. Sadik Idrizi

Ministër i Shëndetësisë



**Postal Address:**  
UNMIK - Kosovo  
P.O. Box 515 or 596  
1000 Skopje  
FYR Macedonia

**Telephone:**  
Via Pristina PTK:  
+381 38 504 604  
Via UNHQ New York:  
+1(212) 963 8442

**Fax:**  
Via Pristina PTK:  
+381 38 504 604 ext. 4019  
Via UNHQ New York:  
+1 (212) 963 8603/8113  
Internal fax: 4065